



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM

VENDIM

Nr. 9, datë 15.07.2021

PËR

**MIRATIMIN E RINOVIMIT TË LEJES “PËR RINOVIMIN E
KUSHTEVE TË LEJES/AUTORIZIMIT”,
SHOQËRISË “ALBA-ROAD” SH.A.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm.

V E N D O S I:

1. Miratimin e rinovimit të lejes për përdorim burimi ujor nëntokësor nëpërmjet shpimit për qëllime industriale, subjektit “Alba-Road” sh.a., me vendndodhje Bashkia Tiranë, Qarku Tiranë sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor

- $Z=63.7$ m.m.n.d
Sasia e ujit që do të përdoret $Q=0.6$ l/sek

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KBU ISHËM

ROLAND NASTO

